

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Dosja Sherbimit Sekret: Si i hapte dyert e Portit të Durrësit Liburn Aliu, me urdhër të Vlora Hysenit dhe E rgys Agasit
ADRESA	https://prapaskena.com/2026/09/28/dosja-sherbimit-sekret-si-i-hapte-dyert-e-portit-te-du rresit-liburn-aliu-me-urdher-te-vlora-hysenit-dhe-ergys-agasit/
BURIMI	prapaskena.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 15:41:46 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 15:27:04 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	96498e7dfa1fd1496b8d010e4bbb24f7d20cac95282ad91f4bfb65b23f42911
TEKSTI	fd6b9bf3f196af15faed70979215d5fc3f56a5d0e71a0aaf092791693d3f37b8
PAMJA	893c4cf4b5b09d5055655f35728de98f92f97f47649ced3aa2cd7982332e020e

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	19dacd26675d30fda5f652dd937f6a21c6226b8e5b1a520126ce307a0ee25105
E MËPARSHMJA	—
RRËNJJA MERKLE	2a9c3c61cd0a94fc8d628189ad3d77be9fe8dbec0733dde85be2277fcecbb101e
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/19dacd26675d30fda5f652dd937f6a21c6226b8e5b1a520126ce307a0ee25105>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Dosja Sherbimit Sekret: Si i hapte dyert e Portit të Durrësit Liburn Aliu, me urdhër të Vlora Hysenit dhe Ergys Agasit

Kryesore

Publikuar: 28/09/2026



Iemëruar në krye të Portit të Durrësit nga dyshja Vlora Hyseni dhe Baton Haxhiu, Liburn Aliu kontaktoi brenda një jave me Vlorën, Ilir Prodën dhe Ergys Agasin; por bisedat nuk ishin për luftën kundër krimit, por për të lejuar kalimin e lirë të trafiqeve e kontrabandës. Në përgjimet e BKH-së, 10 muaj biseda për kompani e individë me dosje, që duheshin favorizuar nga porti.

Në dosjen "Hyseni-Agasi" ka edhe personazhe me funksione drejtuese në agjencitë dhe shërbimet e sektorëve strategjikë, të cilët kanë qenë të përfshirë aktivisht në veprimtaritë e paligjshme kundër interesave të shtetit e në favor të grupeve kriminale.

Liburn Aliu, ish-ministër i Infrastrukturës në Qeverinë "Kurti 2", ishte përzgjedhje dhe rekrutim i Vlora Hysenit dhe Baton Haxhiut, për ta katapultuar në krye të Portit Detar të Durrësit, si garanci e vazhdimësisë së aferave korruptive dhe lehtësive për trafiket dhe kontrabandën.

Sipas të dhënave të dosjes hetimore, rezultojnë se drejtori Liburn Aliu, në fillim të muajit nëntor 2025, vetëm 1 javë pas emërimit në krye të Portit Detar të Durrësit, ka nisur kontaktet telefonike dhe fizike me ish-Drejtorin e SHISH-it, Vlora Hyseni, me ish-Drejtorin e Policisë së Shtetit, Ilir Proda, dhe me "Koordinatorin" Ergys Agasi.

Me të lexuarat



Nga Hati tek prokurori i SPAK, personazhet në videot e Gys Agasit (Kryesore)



media e vëllezërve Veshaj që i blenë Fidel Yllit për 300 mijë euro,



biznesmenia të patmenat e fjetës së Alket



Rizait, mes burgjeve të Greqisë dhe arratisjeve spektakolare. Parajmërimi tronditës i Bill Gates: Inteligjenca Artificiale mund të vrasë 1 miliard njerëz kokinës/ Nga Kolumbia e Ekuadori në Europë, si u trafikuan mbi 50 tonë drogë



Parajmërimi tronditës i Bill Gates: Inteligjenca Artificiale mund të vrasë 1 miliard njerëz kokinës/ Nga Kolumbia e Ekuadori në Europë, si u trafikuan mbi 50 tonë drogë

Zyrtarisht, drejtori i Portit Detar të Durrësit ka detyrim të kontaktojë dhe bashkëpunojë me drejtuesin e SHISH-it dhe drejtorin e Përgjithshëm të Policisë, për të bashkërenduar luftën kundër veprimtarisë së grupeve të trafikëve, kontrabandës e sigurisë kombëtare. Por të dhënat që kanë dalë nga përgjimet telefonike dhe gjurmimet ambientale në Durrës e Tiranë zbulojnë se, në të shumtën e rasteve, kryespiunia Vlora Hyseni, “koordinatori” Ergys Agasi dhe kryepolici Ilir Proda nuk kanë biseduar me drejtorin e Portit Detar të Durrësit, Liburn Aliu, për çështje të luftës kundër krimit.

Objekt i bisedave të tyre ka qenë hapja e dyerve të Portit Detar në hyrje e dalje, për trafiket e drogës dhe kontrabandës, duke u krijuar lehtësi kalimi e veprimi, nëpërmjet shërbimeve të kontrollit e sigurisë, që janë struktura në vartësi të drejtorit të Portit Detar.

Në biseda janë përmendur emra biznesmenësh e individësh “problematicë”, të rekomanduar dhe dakordësuar, për t’u lejuar të kalojnë lirisht pa kontroll në Portin e Durrësit.

Por ka dhe filmime e fotografime për takime me disa prej tyre, tashmë të skeduar dhe penalizuar nga SPAK e Prokuroria e Durrësit, por dhe nga Policia e Durrësit, por që SHISH-i e policia nuk i kanë regjistruar.

Edhe nëse nuk do të kishin biseda e takime për luftën kundër krimit; sipas ligjit, drejtori i Portit Detar të Durrësit ka detyrim të kontaktojë dhe bashkëpunojë me drejtuesin e SHISH-it dhe me drejtorin e Përgjithshëm të Policisë.

Por pyetja që shtrohet është kjo: Mbi ç’bazë ligjore Drejtori i Portit Detar të Durrësit ka kontaktuar për çështje konfidenciale të aktivitetit në Portin Detar me Ergys Agasin, që nuk ka asnjë funksion shtetëror e asnjë tagër për informacione mbi veprimtarinë brenda Portit?

Në materialet hetimore të BKH-së, mes drejtorit Liburn Aliu dhe dyshes Hyseni-Proda, ka biseda të zhvilluara gjatë 10 muajve, nëntor 2025 – gusht 2026, për veprime që janë në shërbim të krimit.

Ka biseda mes Ergys Agasit dhe drejtorit të Portit Detar të Durrësit, Liburn Aliu, për kompani e individë me dosje për veprimtari të paligjshme, që duheshin favorizuar nga shërbimet administrative, të kontrollit e sigurisë në vartësi të portit./**Pamfleti**

TAG:

Ergys agasi

Liburn Aliu

Vlora hyseni





Kumbarët e kokainës/ Nga Kolumbia e Ekuadori në Europë, si u trafikuan mbi 50 tonë drogë

Nga Hati tek prokurori i SPAK, personazhet në videot e Gys Agasit (emrat)



Të pathënat e jetës së Alket Rizait, mes burgjeve të Greqisë dhe arratisjeve spektakolare

Prapaskena

'Prapaskena' lindi si një nismë e një grupi gazetarësh me përvojë dhe plotësisht të pavarur nga çdo parti politike, grup interesash apo klane biznesi, me qëllim për të thënë çdo të vërtetë të guximshme me interes publik. 'Prapaskena' është një media e lirë dhe e pakompromis, e cila ka si qëllim informimin e opinionit publik në mënyrë të paanshme, profesionale dhe në dritën e të vërtetës, mbi çështje që lidhen me korrupsionin politik, krimin, pandëshkueshmërinë, grabitjen e pasurive publike, mbi reformat, sfidat kombëtare dhe lidhjet e padukshme mes partive politike, mediave të njësuar me interesat klienteliste, krimit dhe biznesit jo të ndershëm, të cilët në bashkëpunim përvetësojnë paratë dhe pasuritë publike.'

Copyrights

Çdo kopjim, përdorim apo riprodhim i paautorizuar i këtij materiali është i ndaluar dhe mund të sjellë ndjekje ligjore. Ju lutemi respektoni punën dhe përpjekjen tonë duke mos e shkelur këtë parim.

Kategoritë

[KREU INVESTIGIM](#)

[KRIM & KORRUPSION](#) [DOSJE ROZË](#)

[KRYESORE](#) [POLITIKË](#) [EKONOMI](#)

[ANALIZË](#) [RAJON](#) [KULTURË](#) [SPORT](#)



Email: [\[email protected\]](#)

Copyright © 2025. All Rights Reserved by Prapaskena

[Privacy Policy](#) | [Cookies](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.